

VENDIM
Nr.17, datë 20.1.2007

PËR KOMPENSIMIN E TË ARDHURAVE MUJORE TË PENSIONISTËVE TË FSHATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat mujore të pensionistëve, që marrin pensione pleqërie, pensione invaliditeti dhe pensione familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, që në datë 31.12.2006 janë deri në 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj, të kompensohen deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë.

2. Në kuptim të këtij vendimi, në të ardhurat mujore të pensionistit që merr pension fshati përfshihen:

a) Për pensionistin që banon në fshat, masa e pensionit të pleqërisë, të pensionit të invaliditetit, të pensionit familjar, kompensimi, që jepet sipas vendimit nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”.

b) Për pensionistin që banon në qytet, masa e pensionit të pleqërisë, e pensionit të invaliditetit, të pensionit familjar, kompensimi, që jepet sipas vendimit nr.138, datë 31.3.1994 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, dhe kompensimi, që jepet në përputhje me vendimin nr.471, datë 15.7.1996 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, për pensionistët e qytetit.

3. Kompensimi i të ardhurave mujore të pensionistit, deri në kufirin e pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet, si më poshtë vijon:

a) Pensionistëve, që marrin pensione të plota pleqërie, të cilët para datës 1.1.2007, kanë të ardhura mujore nga 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë deri në 5 000 (pesë mijë) lekë, t’u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj dhe, pas kësaj, shuma e të ardhurave mujore arrin në 5 000 (pesë mijë) lekë.

b) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme pleqërie, të cilët para datës 1.1.2007, kanë të ardhura mujore nën 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë, t’u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet duke shumëzuar masën e pensionit të plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

c) Pensionistëve, që marrin pensione të plota invaliditeti dhe pensione të plota familjare, të cilët para datës 1.1.2007 kanë të ardhura mujore nga 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë deri në 5 000 (pesë mijë) lekë, t’u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj dhe pas kësaj, shuma e të ardhurave mujore arrin në 5 000 (pesë mijë) lekë.

ç) Pensionistëve, që marrin pensione të pjesshme invaliditeti dhe pensione të pjesshme familjare, të cilët para datës 1.1.2007, kanë të ardhura mujore nën 4 310 (katër mijë e treqind e dhjetë) lekë, t’u shtohet shuma deri në 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj.

Masa individuale e kompensimit llogaritet duke shumëzuar masën e pensionit të plotë të kompensimit me masën e pensionit mujor, pjesëtuar me masën e pensionit minimal.

4. Kompensimin shtesë për të ardhurat mujore, të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç” të pikës 3 të këtij vendimi, e marrin edhe pensionistët që datën e fillimit të pensionit e kanë nga data 1.1.2007 e në vazhdim, përfshirë dhe këtë datë.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2007, në shumën 1 344 milion lekë, të përballohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore i miratuar për vitin 2007.

6. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha